

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.13.11.2020*

13.11.2020

Ora 12:00

RENDI I DITËS

Projektakti “Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e votimit dhe numërimit elektronik që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ:**
- **Ilirjan CELIBASHI Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
- **Lealba PELINKU Nënkomisioner Shtetëror i Zgjedhjeve**
- **Komisioni Rregullator:**
- **Ilirjana NANO Kryetar**
- **Arens ÇELA Anëtar**
- **Dritan ÇAKA Anëtar**
- **Helga VUKAJ Anëtar**
- **Muharrem ÇAKAJ Anëtar**
- **Stafi KQZ Y.Merkaj, N.Mezini**
- **Parti Politike PD, LSI**
- **Vëzhgues: KRIK**

Znj.I.Nano: Mirëdita, fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator. Janë të pranishëm pesë anëtarët e Komisionit Rregullator. Gjithashtu në mbledhje është i pranishëm Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Kemi dhe përfaqësues të administratës së KQZ-së, përfaqësues të partive politike parlamentare. Mbledhja e sotme ka vetëm një pikë të rendit të ditës

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.13.11.2020*

shqyrtimin dhe miratimin e projektvendimit “Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e votimit dhe numërimit elektronik që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë”. Ky projektvendim vjen për shqyrtim dhe miratim në Komisionin Rregullator, pasi ne kemi miratuar më herët një vendim “Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e identifikimit elektronik të zgjedhësve që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë”. I jap fjalën Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve zotit Celibashi për të prezantuar projektin.

Z.I.Celibashi: Faleminderit zonja Kryetare, ashtu sikurse dhe ju e thatë, në vijim të përmbushjes së angazhimeve që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka për përgatitjen e zgjedhjeve të 25 Prillit 2021 dhe të disa përgjegjësive specifike që Kodi Zgjedhor i ngarkon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ne së bashku me Nënkomisioneren Pelinku, i kemi paraqitur sot Komisionit Rregullator projektaktin “Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e votimit dhe numërimit elektronik që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë”. Kodi Zgjedhor në nenin 22 të tij dhe nenin 179 përcakton kompetencën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për teknologjinë, përgjegjësinë, të drejtën, por dhe detyrimin e KQZ-së për të implementuar projekte pilot për sa i përket votimit dhe numërimit elektronik, në jo më shumë se 20% dhe jo më pak se 10% të qendrave të votimit. Jemi përpjekur që në këtë akt të reflektojmë dhe të pasqyrojmë maksimalisht të gjitha ato eksigjencat e të gjithë faktorëve të interesuar dhe pjesëmarrës në procesin zgjedhor. Pa dyshim pritshmëria për përdorimin e teknologjisë së informacionit në zgjedhjet e vitit të ardhshëm përbën një risi dhe lidhet ngushtësisht me përcaktimet e Kodit Zgjedhor. Ne jemi përpjekur që të ofrojmë në këtë akt ato karakteristika që ne mendojmë që

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.13.11.2020*

duhet ti gëzojë sistemi i votimit dhe numërimit elektronik. Duke filluar nga siguria, integriteti i sistemit, efektshmëria dhe dobishmëria dhe padyshim edhe transparenca. Shkurtimisht po bëj një listë të karakteristikave që duhet të gëzojë ky sistem, të paktën sipas opinionit tonë, pasi në fund të fundit do të jeni ju organi që do të vendosni për këtë çështje. Fillimisht dua të them që sistemi i votimit elektronik dhe i numërimit elektronik është i ndarë dhe nuk ka asnjë lloj lidhje në çdo pikëpamje juridike, por dhe teknike me sistemin e identifikimit. Janë dy projekte krejt të ndryshëm edhe në pikëpamje të rregullimit, por dhe në pikëpamje të funksionimit teknik të tyre. Janë të pavarur nga njëri tjetri. Sistemi i votimit elektronik dhe sistemi i numërimit elektronik është një sistem që do të veprojë në mënyrë lokale, autonome për çdo qendër votimi. Nuk do të jetë i lidhur në rrjet. Pra, nuk do të jetë on-line. Paisjet ose makineritë që do të vendosen në qendrat e votimit do të jenë të dedikuara vetëm për qendrën e votimit përkatëse. Do të mundësojë ruajtjen dhe sigurinë e votimit, por duke siguruar nga ana tjetër edhe fshehtësinë e votës. Kemi propozuar që sistemi të ketë mundësinë edhe të lënies së gjurmës fizike. Pra, krahas zgjedhjes në mënyrë elektronike të alternativës nga votuesi dhe shënimit të kësaj zgjedhje në mënyrë elektronike, paisja do të ofrojë dhe një version të printuar të fletës së votimit, pasi votuesi do të bëjë zgjedhjen e tij. Kjo bëhet me qëllimin që në rast të një procesi ankimor të mundshëm, palët të cilët do të kenë interesin për të bërë verifikimet e duhura, ta kenë këtë mundësi. Pra, nëpërmjet verifikimit të fletës së votimit të printuar. Ne mendojmë që kjo është një garanci më shumë për të gjitha palët. Rrit besimin e palëve në procesin zgjedhor, por dhe për votuesin është një element i cili ndihmon atë të kuptojë qartë dhe të jetë i sigurtë për zgjedhjen që ka bërë. Nga pikëpamja teknike, sistemi që ne kemi propozuar gëzon ato karakteristika që e bëjnë të lehtë procesin e votimit për votuesin. I krijojmë mundësinë votuesit që ai ta ketë të qartë se kush do të jetë

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.13.11.2020*

zgjedhja e tij dhe të mos krijohet konfuzion në këtë zgjedhje. Pa dyshim që duke qenë një risi, askush nga ne nuk mund të thotë sot, se si do të jetë fati i këtij procesi, por në pikëpamje teknike dhe më vonë edhe në pikëpamje të rregullimit juridik, ne kemi synuar të ofrojmë një sistem që të jetë të paktën qartësisht i kuptueshëm për të gjithë dhe qartësisht gjithkush ta shohë me besim këtë sistem. Më pas koha do të tregojë edhe se sa i dobishëm do të jetë ky moment, faleminderit!

Znj.I.Nano: Faleminderit Komisioner, më parë u drejtohem anëtarëve të komisionit, më tej dhe pjesëmarrësve të tjerë. Nëse kanë ndonjë pyetje pas relatimit të Komisionerit dhe prezantimit të projektaktit dhe relacionit përkatës, sipas nenit 26, pika 2 të rregullores së mbledhjeve të Komisionit Rregullator. Çdo anëtar i Rregullatorit, por dhe çdo pjesëmarrës tjetër që ka interes legjitim për çështjen mundet të drejtojë pyetje. Ftoj anëtarët e Komisionit Rregullator nëse kanë ndonjë pyetje? Përfaqësuesit e partive politike?

Përfaqësuesi i LSI-së: Nuk kemi e nderuar!

Znj.I.Nano: Faleminderit, duke qenë se nuk kemi pyetje, diskutime, kërkesa për sqarime lidhur me prezantimin dhe paraqitjen e relacionit nga ana e Komisionerit për projektvendimin që jemi duke shqyrtuar dhe miratuar, unë do t'i ftoja kolegët ta votojmë në parim dhe më tej të vijojmë me shqyrtimin, diskutimin dhe miratimin nen për nen. Votojmë në parim projektaktin "Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e votimit dhe numërimit elektronik që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë".

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.13.11.2020*

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet në parim projektvendimi. Do të nisim shqyrtimin e tij për çdo pikë. Baza ligjore siç edhe u tha është neni 20, pika 1, germa “e” që përcakton detyrimin e Rregullatorit për të miratuar këtë kategori aktesh. Neni 22, pika 1 dhe 3 dhe neni 179, pika 1 i “Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”. Neni 12, pika 4 e Kodit Zgjedhor përcakton se Komisioni Rregullator është organi kompetent për miratimin e akteve me karakter normativ në fushën e zgjedhjeve, ndjesë, neni 20... dhe vendosjen e rregullave për zgjedhjet. Gjithashtu “Kodi Zgjedhor” ka parashikuar kompetencën e Komisionit Rregullator për miratimin e projektaktit me karakter normativ, për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet apo pajisjet e teknologjisë së informacionit, që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë. Në nenin 179, pika 1 të Kodit Zgjedhor, parashikohet se sistemet apo pajisjet e teknologjisë së informacionit, që do të përdoren në zgjedhje, pikërisht ato paisje të cilat ne sot do të miratojmë llojet dhe karakteristikat teknike do të duhet të përfshijnë jo më shumë se 20% të zgjedhësve, ndërkohë dhe jo më pak se 10% të tyre duke filluar nga zgjedhjet e para pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Kujtojmë që janë ndryshimet e korrikut të këtij viti. Pra, zgjedhjet e para janë ato të 25 Prillit 2021. Nisur nga sa më sipër Komisioni Rregullator vendosi:

Marrim **pikën 1**. Në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021, procesi i votimit dhe numërimit të votave, ku do të zbatohen projekte pilot, të cilat duhet të përfshijnë jo më pak se 10 përqind dhe jo më shumë se 20 përqind të zgjedhësve, do të kryhet me anë të sistemit dhe/ose pajisjeve elektronike, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.13.11.2020*

Pyetje, komente, diskutime, sugjerime? Jo! E votojmë pikën 1?

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Pika 2. Për votimin dhe numërimin elektronik do të implementohet Sistemi Elektronik i Menaxhimit të Votimit dhe Rezultateve (SEMVR) dhe do të përdoren Pajisje Elektronike të Votimit dhe Numërimit (PEVN).

Pyetje, diskutime? Kalojmë në votim!

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Po zoti Çakaj!

Z.M.Çakaj: Një sugjerim, mbledhjen e kaluar ne vendosëm që meqenëse të gjitha palët janë njohur me aktin. Duke qenë se dhe për ne, nuk është i panjohur akti, pasi gjatë gjithë javës jemi njohur me draftin, e kemi shqyrtuar, kemi diskutuar, e kemi ndryshuar, besoj se të gjitha palët janë njohur. Për thjeshtësi mund ta votojmë si herën e kaluar. Mund të themi neni 1 dhe ta votojmë. Gjithësesi mbetet në çmimin e kolegëve të Rregullatorit.

Znj.I.Nano: Absolutisht jam shumë dakord me ju. Projektvendimi është njoftuar dhe publikisht. Ne si anëtarë të Rregullatorit jemi njohur paraprakisht me të. Palët gjithashtu, personalisht do të doja që edhe pse mund të na marrë pak më tepër

***Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU***



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.13.11.2020*

kohë, ndoshta pika 10 ku parashikohen disa karakteristika teknike për të qenë më transparentë dhe për të njohur ...

Z.M.Çakaj: Pa diskutim që pikat që kanë nevojë për diskutim dhe që duhet të rrihen dhe mendimet, pa diskutim që po, për të tjerat nuk është nevoja.

Znj.I.Nano: Edhe për të njohur publikun me përmbajtjen e këtij projektvendimi që besoj se është i rëndësishëm.

Pika 3. Nëse nuk ka diskutime e votojmë?

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Pika 4.

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Pika 5.

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Pika 6.

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.13.11.2020*

Miratohet!

Pika 7.

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet pika 7!

Pika 8.

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet pika 8 e projektvendimit!

Pika 9.

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet pika 9!

Vijmë tek **pika 10**. Unë do të doja të ndalesha në mënyrë që dhe publiku të njihet me disa karakteristika teknike që në fakt më tepër për të ofruar garancinë për elementë teknikë të sistemit dhe paisjeve.

Germa "a" e pikës 10. Qendra e Votimit duhet të jetë e pajisur me të paktën dy PEVN. Është pas parasysh konfigurimi i tanishëm i qendrave të votimit ku kemi dy dhoma votimi.

Germa "b". Procesi i identifikimit dhe procesi i votimit dhe numërimit elektronik janë tërësisht të ndarë prej njëri tjetrit për të pamundësuar lidhjen e votuesit me votën. Gjithashtu nuk duhet të ketë komunikim apo shkëmbim të dhënash midis

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.13.11.2020*

pajisjeve elektronike të identifikimit (PEI) dhe pajisjeve elektronike të votimit dhe numërimit (PEVN).

Germa “c”. Sistemi duhet të garantojë plotësisht integritetin e të dhënave që ruhen në pajisje. Çdo votë në PEVN duhet të ruhet në dy memorie fizike të veçanta, por pjesë të pajisjes, pa referenca kohore dhe duhet të garantohet me standardet më të larta të fshehtësisë. PEVN i garanton votuesit konfirmimin e votës nëpërmjet shfaqjes së saj në ekran. PEVN do të mundësojë versionin elektronik dhe versionin fizik të votës. Versioni fizik i votës do të printohet dhe të bjerë në kutinë e montuar në pajisje. Po zonja Vukaj!

Znj.H.Vukaj: Zonja Kryetare, këtu kemi dakordësuar që versionin fizik të votës do të printohet dhe do të bjerë në kutinë e montuar në pajisje. Thjesht të bëhet “do të bjerë”.

Z.M.Çakaj: Thjesht të shtohet një “do”.

Znj.I.Nano: Dakord! Versionin fizik të votës do të printohet dhe të bjerë në kutinë e montuar në pajisje.

Germa “d”. Ekranin me prekje të PEVN duhet të ketë përmasa të mjaftueshme për t’u përdorur lehtësisht nga votuesi dhe të pamundësojë për aq sa është e mundur, fotografimin e votës.

Germa “e”. PEVN duhet të garantojë prodhimin fizik të raporteve, sipas kërkesave të KQZ-së.

Germa “f”. PEVN duhet të jetë një pajisje plotësisht e integruar, pa komponentë të jashtëm e cila mund transportohet dhe të vendoset në punë lehtësisht. PEVN duhet të pamundësojë çdo ndërhyrje të paautorizuar ndaj çdo komponenti të brendshëm

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.13.11.2020*

ose porte komunikimi, duhet të jetë fizikisht e mbyllur dhe e siguruar me vula sigurie. Kutia që ka dokumentin e printuar sipas parashikimit të germës “c” të pikës 10 të këtij vendimi duhet të sigurojë integritetin fizik të saj nga ndërhyrje të paautorizuara.

Germa “g”. Po zonja Vukaj!

Znj.H.Vukaj: Kutia që ruan në fakt, pra kutia që ruan/mban dokumentin e printuar sipas parashikimit të germës “c”.

Znj.I.Nano: Pra kemi një propozim nga zonja Vukaj “ruan/mban”...

Z.M.Çakaj: Një sugjerim duke qenë se neni 10 përbëhet nga shumë pika dhe duke qenë se mund të kemi dhe sugjerime të tjera, mendoj që të votojmë çdo germë për ndryshimet apo propozimet.

Znj.I.Nano: Dakord! I rikthehem dhe njëherë, pa vijuar leximin. **Germa “a”** e pikës 10. **Kush është dakord?**

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S’ka

Miratohet!

Germa “b” e pikës 10. **Kush është dakord?**

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S’ka

Miratohet!

Germa “c” e pikës 10. **Kush është dakord?**

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.13.11.2020*

Kundër: S'ka

Miratohet!

Germa "d" e pikës 10. **Kush është dakord?**

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Germa "e" e pikës 10. **Kush është dakord?**

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Germa "f" e pikës 10. Pra me propozimin e zonjës Vukaj "ruan/mban".

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Germa "g" PEVN duhet të veprojë në mënyrë autonome dhe pa u lidhur në rrjetet e komunikimeve elektronike.

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Germa "h". PEVN duhet të:

- i. Aktivizhet për çdo votues nga ana e Komisionerit të QV-së.
- ii. Mbyllet automatikisht pas votimit të çdo votuesi.
- iii. Shfaqë qartë fletën e votimit sipas modelit të miratuar nga KQZ-ja.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.13.11.2020*

iv. Mundësojë që zgjedhësi të votojë në përputhje me parashikimet e Kodit zgjedhor.

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Germa "i". PEVN duhet të ketë bateri për të operuar përgjatë gjithë procesit të votimit dhe numërimit, të pavarur nga energjia elektrike.

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Germa "j". Në rastet kur procesi i votimit ka më shumë se një votim (zgjedhje të përgjithshme, zgjedhje vendore, referendum etj), votuesit do t'i jepet mundësia të votojë me radhë për secilin nga llojet e votimit.

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Germa "k". Votuesit duhet t'i mundësohet verifikimi dhe konfirmimi i çdo zgjedhjeje të bërë, përfshirë dhe konfirmimin e verifikimit të versionit fizik të votës. Zoti Çakaj!

Z.M.Çakaj: Një sugjerim të vogël, ose shtesë, propozim. Duke qenë se në pikën "d" kemi vendosur si standard që "Ekрани me prekje i PEVN duhet të ketë përmasa të mjaftueshme për t'u përdorur lehtësisht nga votuesi dhe të pamundësojë për aq

***Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU***



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.13.11.2020*

sa është e mundur, fotografimin e votës” si dhe duke qenë se në konceptin tonë për mënyrën e votimit elektronik dhe votën që do të prodhojë, kemi konceptin e dakordësuar që vota është një dhe ka versionin elektronik dhe versionin fizik. Mos do të ishte mirë që për shkak të ruajtjes së fshehtësisë së votës, meqenëse e vendosëm në ekran, ta vendosim dhe tek kjo? Të njejtin formulim të pikës “d”, pra të pamundësojë fotografimin e votës.

Znj.I.Nano: Në fakt me sa shoh kjo është një çështje teknike për ekranin.

Z.M.Çakaj: Po, për llojin, karakteristikën që ekрани që përmban kutinë e votave fizike të pamundësojë për aq sa është e mundur fotografimin. Pra, nëse ekрани i votimit elektronik do të pamundësojë fotografimin e votës elektronike, i njejtin standard duhet të mbahet dhe për ekranin e votës fizike. Shkojmë në të njejtin standard.

Znj.I.Nano: Vota fizike do të mbahet në një kuti..

Z.M.Çakaj: Po, në një kuti. Ideja është këtu që nuk duhet të lejohej., ose karakteristikat teknike të paisjes nuk duhet të lejojnë për aq sa është e mundur fotografimin e votës. Si ekрани ku votohet në mënyrë elektronike, ashtu dhe kutia...

Znj.H.Vukaj: Pra, kutia ku ajo do të shfaqet përpara se të bjerë.

Z.M.Çakaj: Pra, i njejtin formulim të bëhet si në pikën “d”. Propozimi im është që të bëhet i njejtin formulim.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.13.11.2020*

Znj.H.Vukaj: Pra, sensi teknik i të gjithë propozimit ka qenë jo vetëm fshehtësia e votës, transparenca e votës, por njëkohësisht dhe garancia, apo siguria për shprehjen e vullnetit. Pra, që do të thotë votova elektronikisht, konfirmova përmes vullnetit tim të lirë, por përpara se kjo votë të printohet, unë dua edhe një garanci ekstra si votues e cila më jepet në momentin përpara se kjo të printohet. Ky është momenti që siç presupozohet nga propozimi apo nga moderuesit, apo nga ata që e kanë draftuar teknikisht, që kjo votë do të shfaqet përpara se të bjerë e printuar. Kjo për të garantuar vullnetin maksimalisht deri në fund. Unë këtë kuptova nga propozimi i zotit Çakaj dhe jam në sinkron me pjesën që tha ta dublojmë dhe në këtë pikë.

Z.M.Çakaj: Thjesht, parimi i parashikuar në “Kodin Zgjedhor”, fshehtësia e votës, vota është e fshehtë. Duke qenë se vota është një si elektronike, si fizike thjesht të ruhet në të njejtin standard. Kjo të materializohet dhe në llojin e karakteristikat teknike të paisjes. Pra, biem dakord që paisja e votimit dhe numërimit elektronik përbëhet nga dy njësi. Njësia e votimit elektronik dhe njësia kutia që është ngjitur me këtë ku depozitohen votat fizike.

Znj.I.Nano: Dakord! A mundet ta formalizoni propozimin tuaj me fjalë në cilën pikë doni shtesë?

Z.M.Çakaj: Po patjetër, në germën “k” të riformulohet “votuesit duhet t’i mundësohet verifikimi dhe konfirmimi i çdo zgjedhjeje të bërë, përfshirë dhe konfirmimin e verifikimit të versionit fizik të votës si dhe kutia të pamundësojë për aq sa është e mundur fotografimin e votës”.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.13.11.2020*

Znj.I.Nano: Dakord, në parim jam absolutisht dakord. Pra aty në ekran ku kemi votën elektronike do t'i kërkojmë si karakteristikë teknike, ofruesit të implementimit të sistemit pamundësinë e fotografimit të votës dhe pastaj teknikisht është çështje që e zgjidh ai. Ta kërkojmë dhe tek kutia që është pjesë integrale e paisjes së votimit. Votojmë propozimin e zotit Çakaj.

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet germa "k"!

Germa "l." Votuesit dhe komisioni nuk duhet të kenë akses në pajisje dhe as në kutinë e ruajtjes së dokumenteve të PEVN.

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Germa "m". Në përfundim të procesit të votimit dhe mbas inicimit të mbylljes së votimit nga komisioni, PEVN do të përlllogarisë rezultatin dhe do të printojë procesverbalin e rezultatit të QV-së.

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Germa "n". PEVN do të mundësojë përcjelljen në mënyrë të sigurtë të rezultatit në sistemin qendror pranë KQZ-së.

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.13.11.2020*

Kundër: S'ka

Miratohet!

Germa "o". PEVN duhet të mundësojë votimin e votuesve të verbër, duke garantuar fshehtësinë e votës.

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet! Po zoti Çaka!

Z.D.Çaka: Mbase do të ishte mirë tek germa "o" dhe nga pikëpamja gjuhësore "votuesit të verbër", në njëjës?

Znj.I.Nano: Në rregull, mqs është thjesht çështje gjuhësore e rregullojmë. Kalojmë në **pikën 11**. Po zonja Vukaj!

Znj.H.Vukaj: Në kushtet e konsolidimit të këtij akti, por duke parë dhe çfarë ligjvënësi ka parashikuar, si mjet garancie për gjithë këtë iniciativë, ose në përshtatje sa më të sigurtë risisë që po ndërmerr institucioni, Komisioneri dhe Nënkomisioneria, në këtë rast. Unë do të isha në sinkron dhe në përputhje me çfarë ka parashikuar ligjvënësi në këtë pikë për dhënien e një garancie të plotë në kushtet e një vullneti të shprehur në votë, i cili të mos ketë diskordancë, por të ketë rakordancë në mes të asaj që konfirmojmë në paisje dhe asaj çfarë bie në letër. Për këtë arsye do të thoja që si një mjet të shtuar që materialitetin e riskut të mos e lemë ashtu, le të themi parim, apo të hapur. Pra, të mos i japim mundësinë askujt të llogarisë që plus-minusi është pjesë e kësaj makinerie. Këtu kemi të bëjmë me votë dhe jo me parime thjesht auditimi, do të thoja që, përsëri do të mbetem në termat e

**Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.13.11.2020*

auditimit, pra tek matrica e rriskut. Të rrimë tek impakti për siguri të shtuar dhe këtë pikë, unë propozoj që të shtojmë ose një fraksion të pikës 10 dhe të thonim 10/1, ose si një pikë shtesë dhe të jetë 11. Kam propozimin konkret duke thënë që “KQZ-ja për të garantuar besueshmërinë dhe integritetin e procesit, verifikon sistemin sipas nenit 22, pika 7 të “Kodit Zgjedhor”. Me këtë i bëjmë me dije kushdo qoftë operatori teknik, apo ofertuesi, jo vetëm të na japë garanci, por të jetë aq serioz që këto duhet t’i paramendojë dhe t’i ketë të qarta që në momentin e ofertës. Pra, që nuk luhet me votën. Kaq kisha, ju ftoj ta votojmë, nqs nuk ka diskutime të tjera.


Znj.I.Nano: Zonja Vukaj, faleminderit, propozimi juaj është krejtësisht në përputhje me nenin 22 pika 7 të “Kodit Zgjedhor” ku kërkohet që pas çdo procesi zgjedhor, pas nxjerrjes së rezultatit përfundimtar dhe konstituimit të organeve të zgjedhura, KQZ-ja kryen verifikimin e sistemeve dhe nëpërmjet numërimit manual në jo më pak se 10 qendra votimi ndër ato qendra votimi ku është aplikuar teknologjia për votimin dhe numërimin elektronik. Nga ana teknike, unë do të thoja mund ta shtojmë si pikë 11. Mendoni të transfuzojmë nenin 22, pika 7, apo do të gjejmë një formulim. Keni ju një formulim gati?

Znj.H.Vukaj: Unë sapo lexova një formulim dhe them që pika 11 duhet të jetë “KQZ-ja për të garantuar besueshmërinë dhe integritetin e procesit, verifikon sistemin sipas nenit 22, pika 7 të Kodit Zgjedhor”.

Znj.I.Nano: E hedhim në votim propozimin e zonjës Vukaj për të shtuar një pikë, pikën 11 pas pikës 10?

Kush është dakord?

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.13.11.2020*

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Pika 11 e projektaktit bëhet 12 “Me qëllim implementimin dhe përdorimin e sistemit elektronik të votimit dhe numërimit, në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 prill 2021, duke marrë në konsideratë kohën e shkurtër në dispozicion të KQZ-së si dhe referuar parashikimit ligjor të nenit 179, pika 1 dhe 3 të Kodit Zgjedhor, Autoriteti Kontraktor mund të përdorë procedurën e prokurimit të parashikuar në nenin 33, pika 2, germa “c” të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar”.

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet pika 12!

Kalojmë në **pikën 13**.

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet pika 13!

Pika 13 që bëhet **pika 14**. E drejta e ankimit.

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet pika 14!

Pika 15. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.13.11.2020*

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Të nderuar kolegë, ju ftoj ta miratojmë aktin në tërësi. E kemi miratuar në parim projektvendimin, kemi kaluar çdo pikë një për një, sipas rregullores, me propozimet përkatëse. Votojmë në tërësi aktin.

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Miratohet projektvendimi “Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e votimit dhe numërimit elektronik që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë”. Duke qenë se nuk kemi pikë tjetër në rendin e ditës, mbledhjen e deklaroj të mbyllur, faleminderit!

Vendimi nr.4

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*